



▶ “ALI IBRA” NJË PROJEKT HUMAN PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN.....1



▶ PËRDORIMI I GJUHËVE ZYRTARE NË KOSOVË – NGA TEORIA NË PRAKTIKË.....1



▶ QEVERIA E KOSOVËS VAZHDON PËRKRAHJEN E PROJEKTEVE PËR KOMUNAT E REJA .....2



▶ PROMOVOHET IDENTITETI DHE KULTURA E KOMUNITETIT MALAZEZ TË KOSOVËS ...2



Republika e Kosovës – Republika Kosovo – Republic of Kosovo  
 Qeveria – Vlada – Government  
 Zyra e Kryeministrit – Kancelarija e Premijera – Office of the Prime Minister  
 Zyra për Çështje të Komuniteteve / Kancelarija za pitanje zajednica / Office for Community Affairs

# Fuqia në diversitet

## LAGJJA E RE “ALI IBRA” NJË PROJEKT HUMAN PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN

*Projekti i cili ka një karakter të lartë njerëzor do të bëjë zgjidhjen e problemit të banimit të qytetarëve të ish lagjes ‘Kolonja’ në Gjakovë. Me këtë do të zgjidhen edhe shumë probleme sociale që i preokupojnë jo vetëm banorët e kësaj lagjeje, por edhe Qeverinë e Kosovës*



Investimi në vlerë prej afro dy milionë eurosh për ndërtimin e një infrastrukture moderne, përfshirë këtu edhe ndërtimin e 125 shtëpive për familjet në nevojë, projekt ky që pritet të realizohet brenda dy vitesh, është investim i Qeverisë së Kosovës, përkatësisht i Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Zyrë të Kryeministrit, Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Komunës së Gjakovës si dhe partnerëve ndërkombëtarë, CARITAS-it zviceran dhe Qeverisë Austriake, që do të garantojë strehimin dhe integrimin e plotë të komuniteteve që jetojnë në lagjen ‘Ali Ibra’ të Gjakovës.

Faza e parë e këtij projekti ku parashihet ndërtimi i 29 shtëpive filloi implementimin në tetor të këtij viti. Për fazën e parë të punimeve Zyra për Çështje të Komuniteteve ka ndarë 100 mijë euro.

Vënia e gurthemelit të këtij projekti në lagjen ‘Ali Ibra’ është investimi i radhës që dëshmon përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për integrimin e plotë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, si pjesë e barabartë e shoqërisë kosovare shumëetnike.

Ky investim kapital rrezaton partneritetin midis qeverisë qendrore, lokale dhe institucioneve ndërkombëtare. Sfidë mbetet implementimi i projektit sipas standardeve që kërkohen, në mënyrë që qytetarët të gëzojnë një infrastrukturë të niveleve evropiane. Në ceremoninë e vënies së gurthemelit të këtij projekti ishte i pranishëm Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, i shoqëruar nga zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, zëvendësministri i Ministrisë së Kthimit dhe Komuniteteve, Ismet Hashani dhe kryetari i komunës së Gjakovës, Pal Lekaj. Gjatë ceremonisë Kryeministri Thaçi premtoi përkushtimin dhe angazhimin e Qeverisë së Kosovës në përmbylljen sa më të shpejtë dhe të suksesshme të këtij projekti.

Lagja Ali Ibra në Gjakovë është lagje joformale me rreth 780 banorë kryesisht të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, por edhe familje shqiptare dhe serbe që jetonin në kushte të vështira ekonomike dhe sociale. Sipas planit rregullues aktual kjo lagje do të shndërrohet në një zonë urbane moderne në të cilën përveç shtëpive, do të ndërtohet edhe një shtëpi e shëndetit, kopshti i fëmijëve, parkingje, fusha sportive dhe terreni për rekreacion.



Adresa: Ndërtesa e Qeverisë; Sheshi Nëna Terezë p.n.

Tel: +381 /0/ 38 200 14 444

Email: [zck-kpz@ks-gov.net](mailto:zck-kpz@ks-gov.net)

[www.kryeministri-ks.net/zck/](http://www.kryeministri-ks.net/zck/)

## PËRDORIMI I GJUHËVE ZYRTARE NË KOSOVË - NGA TEORIA NË PRAKTIKË

ZÇK organizoi punëtori për vetëdijesimin e komuniteteve jo-shumicë mbi të drejtat e tyre në përdorimin e gjuhëve



Me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit të komuniteteve për të drejtat e tyre gjuhësore, si dhe mjetet juridike në dispozicion, Zyra për Çështje të Komuniteteve në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për të Drejtat e Pakicave (ECMI) organizoi tri punëtori rajonale. Mbi pesëdhjetë pjesëmarrës të cilët ishin nga qeveritë lokale dhe përfaqësues të komuniteteve jo-shumicë morën pjesë në këto punëtori të cilat u zhvilluan në regjionin e Prishtinës, Gjilanit dhe në regjionin e Prizrenit.

Punëtoritë u ndanë në dy pjesë. Pjesa e parë e seminarit përfshinte informacione mbi kuadrin ligjor dhe institucional për mbrojtjen e të drejtave gjuhësore. Ndërkaq pjesa e dytë e organizuar në formë të tryezës së rrumbullakët përfshinte ushtrime bazuar në praktikën e organeve qendrore dhe lokale në zbatimin e të drejtave për përdorimin e gjuhëve në Kosovë. Prezantuesit ishin ekspertë nga ZÇK, Komisioni për Gjuhë dhe ECMI.

Informacionet dhe të dhënat e mbledhura përmes diskutimeve me pjesëmarrësit dhe pyetësorëve, shërbejnë si kontribut në zhvillimin e rekomandimeve për të përmirësuar efikasitetin e politikave të gjuhëve, të cilat do të përfshihen në studimin mbi përdorimin e gjuhëve në Kosovë, në të cilin aktualisht janë duke punuar ZÇK dhe ECMI.

## QEVERIA E KOSOVËS VAZHDON PËRKRAHJEN E PROJEKTEVE PËR KOMUNAT E REJA

*Përfundoi rikonstruktimi i ndriçimit të rrugës që lidh nëntë fshatra me qendrën e komunës së Graçanicës*

Rruga që lidh nëntë fshatra të komunës së Graçanicës tashmë jo vetëm që ka një pamje më të bukur me ndriçim, por është më e sigurt për udhëtim të qytetarëve.



Duke filluar nga fshati Livaxh e deri në Preoc, janë vendosur shtylla ndriçimi në të dy anët e rrugës, në mënyrë që banorëve të kësaj zone t'u krijohen kushte më të mira për jetesë duke u ofruar mundësitë që edhe në orët mbrëmjes të zhvillojnë aktivitetet e ndryshme shoqërore nën dritat e neonit. Po ashtu, kjo rrugë e ndriçuar do të shërbejë edhe për siguri më të madhe të qytetarëve.

Ndriçimi i këtij segmenti rrugor është investimi i radhës që ZÇK kontribuoi në zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës në komunat e reja. Punimet janë realizuar sipas parametrave bashkëkohorë me synim rritjen e ndjeshme të cilësisë së jetës për banorët e kësaj zone.



## PROMOVOHET IDENTITETI DHE KULTURA E KOMUNITETIT MALAZEZ TË KOSOVËS

*Qeveria e Kosovës iu ofron kushte të barabarta të gjitha komuniteteve duke i mbështetur me projekte të ndryshme për promovimin e kulturës, traditës dhe etnitetit të tyre në përgjithësi*



Projekti "Mbështetja e bashkësisë malazeze dhe serbe në rajonin e Pejës" që ka për qëllim sensibilizimin mbi ekzistencën, kthimin dhe gjetjen e mundësisë së punësimit të pjesëtarëve të komunitetit malazez të Kosovës, filloi implementimin në muajin tetor të këtij viti.

Ceremonia e fillimit të këtij projekti u shënuar në tetor të këtij viti nga Shoqata e Malazezëve të Kosovës, me ç'rast u organizua edhe një konferencë për media në Gorazhdevc, ku kryetari i kësaj shoqate paraqiti edhe disa shqetësime që më shumë ndërlidhen me çështje politike e që i preokupojnë malazezët e Kosovës.

ZÇK do të vazhdojë edhe më tutje financimin e projekteve që kanë për qëllim të mbështesin integrimin e komuniteteve jo-shumicë, e në këtë rast përfshirë edhe komunitetin malazez.